



BIBLIOTEKA KOMBËTARE E KOSOVËS
"PJETER BOGDANI"
THE NATIONAL LIBRARY OF KOSOVA
Nr. 364
Dt. 05 / 11 / 2025
Prishtinë

Instituti i Historisë
"Ali Hadri"

Biblioteka Kombëtare e Kosovës
"Pjetër Bogdani"

Nr. 01/156/25 prot.
Prishtinë, më: 05.11.2025

Nr. 364 prot.
Prishtinë, më: 05.11.2025

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

Instituti të Historisë "Ali Hadri" me seli në Prishtinë, i përfaqësuar nga Prof. dr. Teuta Shala-Peli, dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Dr. sc. Blerina Gaxha-Rogova, të cilat në vijim të këtij Memorandumi do të referohen si "palët nënshkruese", në bazë të vullnetit të përbashkët për bashkëpunim institucional në fushat me interes të ndërsjellë, nënshkruajnë këtë memorandum.

Neni 1

Qëllimi i bashkëpunimit

1. Ky Memorandum ka për qëllim vendosjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet palëve në fushat e historisë, trashëgimisë kulturore dhe shkencore.
2. Palët bien dakord të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta për ruajtjen, promovimin dhe zhvillimin e vlerave historike e kulturore, përmes këmbimit të përvojave, literaturës, aktiviteteve dhe projekteve me interes të ndërsjellë.

Neni 2

Fusha e bashkëpunimit

1. Palët nënshkruese pajtohen se bashkëpunimi do të zhvillohet në këto fusha:
 - 1.1. Këmbimi i literaturës profesionale dhe shkencore për nevojat e institucioneve, dhe bibliotekave brenda dhe jashtë vendit;
 - 1.2. Bashkëpunim në hartimin dhe zbatimin e projekteve shkencore e kulturore me interes të ndërsjellë;
 - 1.3. Promovimi dhe prezantimi i veprave me karakter historik dhe kulturor;
 - 1.4. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me tematikë nga historia dhe trashëgimia kulturore;
 - 1.5. Realizimi i ekspozitave dhe formave të tjera të prezantimit publik të historisë dhe trashëgimisë kulturore.

Neni 3

Këmbimi i literaturës

1. Palët pajtohen të bashkëpunojnë në këmbimin e literaturës shkencore, revistave profesionale dhe materialeve tjera që kontribuojnë në pasurimin e fondeve të bibliotekave përkatëse.
2. Ky bashkëpunim ka për synim të ofrojë mbështetje për studiues, studentë, nxënës, si dhe për institucionet arsimore e kulturore.

Neni 4

Projektet kulturore-shkencore

1. Palët do të bashkëpunojnë në identifikimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta shkencore dhe kulturore, në përputhje me interesat e tyre institucionale dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 2 të këtij Memorandumi.
2. Detajet e projekteve specifike do të rregullohen përmes marrëveshjeve të veçanta ndërmjet palëve, sipas nevojës.

Neni 5

Kohëzgjatja dhe vlefshmëria

1. Ky Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mbetet i vlefshëm për një periudhë pesë (5) vjeçare, me mundësi vazhdimi me pajtimin e palëve.
2. Çdo ndryshim ose plotësim i këtij Memorandumi bëhet vetëm me pëlqimin e të dyja palëve, nëpërmjet një aneksi të nënshkruar.

Neni 6

Dispozitat përfundimtare

1. Në dëshmi të pajtueshmërisë së plotë, palët nënshkruajnë këtë Memorandum në dy (2) kopje identike, nga një për secilën palë.
2. Të dy kopjet kanë të njëjtën fuqi juridike dhe vlefshmëri.

Për dhe në emër të
Institutit të Historisë

“Ali Hadri”

Prof. dr. Teuta Shala-Peli
Drejtoreshë



Për dhe në emër të
Bibliotekës Kombëtare të Kosovës
“Pjetër Bogdani”

Dr. sc. Blerina Gaxha-Rogova
Drejtoreshë e përgjithshme

